

## **Rregullore për regjistrimin e nxënësve**

Kjo rregulloren ka për qëllim që të rregulloj kriteret të cilat duhet të përmbahen për regjistrimin dhe aplikimin e nxënësve në shkollën e mesme të lartë “Gjimnazi Britanik për Teknologji”. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen përveq me vendim nga këshilli drejtues i shkollës. Procedura e aplikimit dhe regjistrimit të nxënësve, gjendet në dokumentin “Politikat dhe procedurat për regjistrim dhe përzgjedhje”, që gjendet tek menyja “Dokumentet”.

### **Neni 1**

1. Nga data 01.09 të vitit paraprak, hapet konkursi në bazë të kësaj rregullore të publikuar në web të shkolles.
2. Nxënësi I cili aplikon të regjistrohet në “Gjimnazin Britanik për Teknologji”, duhet të iu nënshtrohet testeve pranuese, në lëndën e gjuhës shqipe, matematikës dhe gjuhës angleze.

### **Neni 2**

1. Çdo nxënës që aktualisht është në kl. të 9-të ose e ka mbaruar më herët kl. e 9-të mund të aplikoj.
2. Pas aplikimit të kryer në web të shkolles, çdo nxënës ftohet për të hyrë në teste.

### **Neni 3**

Nxënësi i cili e ka humbur vitin ose është përjashtuar për ndonjë arsye nga shkolle fillore dhe e mesme e ulët nuk mund të regjistrohet.

### **Neni 4**

Nëse nxënësi ka plotësuar kriteret e testit, i rezervohet vendi për tu regjistruar, pasi ta plotësoj dokumentacionin e parapare me ligj.

## Neni 5

1. Në procedurën e regjistrimit është obligative paraqitja e nxënësit dhe e prindit në mënyrë fizike në shkollë.
2. Të gjithë nxënësit do të vrojtohen nga stafi i shkolles gjatë të gjitha procedurave, si nga aspekti i disziplines ashtu edhe nga aspekti i komunikimit.

## Neni 6

Çdo nxënës që aplikon pasiqë është plotësuar numri, kalon në list të pritjes, ku renditet në bazë të kohës së aplikimit.

## Neni 7

1. Pasi të përfundohen të gjitha procedurat e parapara me këtë rregulloren, prindi i nxënësit thirret që të nënshkruaj një parakontratë dhe pasi që nxënësi ta kompetoj dokumentacionin nënshkruhet edhe kontrata mes prindit dhe institucionit.
2. Me rastin e nënshkrimit të parakontrates mes institucionit dhe prindit të nxënësit, prindi është i obliguar që ta kryej pagesën e një shume si garancion për regjistrimin e nxënësit në shkollë.
3. Shuma e pageses bëhet e ditur në parakontraten e nënshkruar nga të dyja palët. Kjo shumë do të zbatohet në shumën që nxënësi duhet të paguaj për një vit sipas kontrates.

## Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi pas votimit në këshillin drejtues dhe nënshkrimit të drejtorit të shkollës.



Drejtoria

A handwritten signature in black ink, appearing to read "G. Mustafa".

Prishtinë, 22.08.2022